REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

ZYRA E BASHKËQEVERISJES DHE PERFORMANCES

Nr.____Prot

Maliq, më 29.06.2026

Lenda: Kthim Përgjigje

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Rr. Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, Kati 10 , Apartamenti 71/73, Po Box; 2418/1.1010
Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj"Kërkesë për informacion", nga emaili i datës, 19.03.2025 dhe protokolluar sipas Bashkisë Maliq nr, 46 prot, datë 10.06.2026, si më poshtë ju dërgojmë informacionin, sipas pikave të shkresës, referuar gjithë informacioneve të mbledhura tek sektorët përkatës:

1. Po, është 400,000 Lekë për vitin 2025.
2. Jo, nuk ka përfituar.

3.Numri total i punonjësve Bashkia Maliq viti 2025 është 343 femra dhe 269 meshkuj.

4. Numri i të rinjve (18-29)vjeç të punësuar në Bashkine Maliq viti 2025 është 35 femra dhe 24 meshkuj dhe persona me aftësi të kufizuar nuk ka.

5.Ka 3 pozicione drejtuese në bashkinë tonë që drejtohen nga të rinjtë të cilët janë, 3 Administratorë të Njësive Administrative (Vreshtas ,Pojan dhe Gorë). Femra 0 meshkuj 3 dhe persona me aftësi të kufizuara nuk ka .

6.Bashkia jonë ka politika rinore dhe vazhdimisht punon për të krijuar mundësi dhe hapësira për të rinjtë duke bashëkupuar me aktorë të ndryshëm.

7.Në institucionin tonë ka staf të dedikuar për rininë ku struktura është ngritur që në vitin 2022 dhe sipas saj stafi funksionin pranë Sektorit të Rekreacionit Turizmit dhe Rinisë ku në përbërje të tij ka përgjegjesin e zyës dhe dy specialistë rinie.

8.Në bashkinë tonë janë ngritur strukturat rinore dedikuar grup moshës së të rinjve (15-29) vjeç , si Këshilli Vendor Rinor , parlamenti rinor , gazeta rinore, struktura konsultative rinore, këto në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm sidomos me organizatën CRCA /ECPAT , që për vitin 2024 ishte bashkëpuntori jonë kryesor me të cilin kemi pasur dhe marrëveshje bashkepunimi në kuadër të projekteve të tyre me foksus të rinjtë .

9.Bashkëpunimet për ngritjen e strukturave, kanë qenë me shumë institucione dhe aktorë të ndryshëm , ku mund të përmëndim një pjesë të tyre si: Universiteti Korçës" Fan Noli ", Zyra e Punës, ZVA Maliq dhe shkollat e territorit të bashkisë Maliq, organizata CRCA /ECPAT Albania dhe organizata te tjera të cilat kanë prezantuar projekte dhe shërbime që ato operojnë.

10. Brënda hapësirave dhe mundësive, ka pasur plan veprimi për KVR-në (Keshillin Rinor Vendor) Maliq , ku janë zhvilluar disa aktivitete të ndryshme rinore , me fokus të rinjtë. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, nga bashëkpunimi, e mbështetja e organizatës CRCA /ECPAT, është bërë i mundur miratimi i planit në vitin 2025 nga Këshilli i Bashkisë dhe do vazhdojë implementimi tij deri në vitin 2028.

11.KVR Bashkia Maliq është krijuar në vitin 2022 dhe në vitin 2024 është rinovuar sipas proçedurës përkatese. Në strukturën e saj ka gjithsej 9 antarë ku të rinj janë 6 dhe të gjithë meshkuj. Persona me aftësi të kufizuara nuk ka. Ne vitin 2025 janë zhvilluar 3 mbledhje por dhe aktivitete të ndryshme.

12.Për të përmirësuar funksionet e K.V.R-së Maliq, në qytetin tonë kemi nevojë për prezencën e aktoreve të ndryshëm, të cilët mund të zbatojnë projektet e tyre për të rinjtë në mënyrë që të rrisim interesin , shërbime, edhe mundësi më të mira, e më të mëdha për të rinjtë që ata të mos largohen nga vendi, si një fenomen që ndihet kohet e fundit për arësyje e rrethana të ndryshme. Gjithashtu të krijohen sa më shumë mundësi financimi e bashkëpunimi për çështjet rinore.

13. Bashkëpunimi ekziston vazhdimisht dhe ne jemi të hapur ndaj çdo lloj aktori e institucioni për të rinjtë që këta të fundit të marrin shërbime, trajnime, informacion dhe çdo lloj mundësie ekzistuese.

14.Në bashkinë tonë për vitin 2025 nuk kanë operuar organizata, vetëm disa bashkëpunime të vogla me disa prej tyre kur është zhvilluar ndonjë aktivitet ose ndonjë sesion ndërgjegjesimi për të rinjtë.

15. Bashkia Maliq gjithmonë ka ofruar mbështeje në forma të ndryshme për çdo aktor që kërkon të bashkëpunojë dhe githmonë është e gatshme për bashkëpunime të ndryshme me inters për të rinjtë që ata të mund te përfitojnë dhe të jenë një zë i rëndësishëm për veten dhe bashkëmoshataret.

16. Aktivitetet për të rinjtë nga bashkia Maliq kanë qenë të ndryshme në vitin 2025 ku mund të përmëndim disa prej tyre si; festat e 7-8 Marsit ,festa e Trendafilave, RIN- ART-2025, Panairi i Embelsirave, aktiviteti letrar në kuadër të muajit të Letërsisë, aktivitete në nderim të figurave të nderit e shumë të tjera .

17.Të rinjtë tek proceset vendimmarrëse të bashkisë janë përfshirë tek të gjitha format për t'u informuar dhe për të qenë një zë i fushqishëm.

18.Janë kryer shumë konsultime publike nga ana e bashkisë, të gjitha kanë qenë të hapura për të rinjtë dhe çdo lloj grupimi e personi, pamvarësisht se intersi dhe numri i të rinjve vazhdon të jetë i ulet për aresyje të ndryshme.

19.Sfida ka plot por ato më të medha mbeten, emigrimi dhe migrimi i të rinjve, interesi i tyre i ulët pamvarësisht shërbimeve e mundësive që ofrohen dhe mungesa e hapsirave të posaçme rinore.

20..Mjetet e komunikimit që bashkia Maliq përdor janë :

Linku i faqes së webit: (https:/bashkia maliq.gov.al/) dhe email: bm@bashkiamaliq.gov.al

Koordinatori për të drejtën e informimit : (enea.bezati@bashkiamaliq.gov.al)

21.Bashkia është e gatshme gjithmonë brënda mundësive dhe hapsirave të saj për çdo lloj forme mbështetje për të rinjtë .

22.Jo

23. Janë të përfshira ne planet sociale dhe barazis gjinore

24..Numri total i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike për vitin 2025 është_1689_ nga ku janë_701__ femra dhe __988_ janë meshkuj.

25. Numri i të rinjve (15-29)vjeç përfitues nga skema e ndihmes ekonomike per vitin 2025 është 750 persona .Nga këto janë 500 femra dhe 250 meshkuj.

26.Numri i përfituesve të pagesës të personave me Aftesi të Kufizuar në total janë: 897 persona nga ku 321 femra dhe 576 meshkuj.

27. Numri i të rinjve (15-29)vjeç përfitues nga pagesa e Aftesisë së Kufizuar për vitin 2025 eshte 270 nga ku 150 jane femra dhe 220 jane meshkuj.

28.Numri total i personave që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 janë 18 nga ku 14 femra dhe 4 meshkuj.

20. Numri i të rinjve (15-29)vjeç që janë pjesë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2025 eshte vetem nje femer.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Koordinatori për të drejtën e informimit:

ENEA BEZATI